

# KANABISI(KËRPI) PËR PËRDORIM MJEKËSOR NË MAQEDONI SHËNDET OSE BIZNES?

PËRMBLEDHJE PËR POLITIKAT PUBLIKE



## Përmbledhje ekzekutive

Legalizimi gjatë i paralajmëruar i kanabisit(kërpit) mjekësor në Maqedoni, i cili hyri në fuqi me ndryshimin e Ligjit për kontrollin e drogave dhe substancave psikotropike nga muaji shkurt i vitit 2016 nuk i plotësoi qëllimet e pritura. Format e arritshme legale të kanabisit nuk i pasqyrojnë nevojat për mjekimin e sëmundjeve dhe gjendjeve të ndryshme shëndetësore, çmimet e shitjes janë tepër të larta, mjekët-profesionistë vetëm kohë pas kohe dhe me skepticizëm shkruajnë receta për preparate nga kanabisi, kurse pacientët furnizohen me barna nga tregu i zi. Ky dokument i tregon lëshimet në zgjidhjen ligjore aktuale që rezultojnë me zbatimin e tij jopërkatës. Për më tepër, dokumenti i përmbledh përvojat dhe qëndrimet e palëve të prekura kryesore dhe bën pasqyrimin e modeleve për rregullimin e kanabisit mjekësor në disa vende, mbi bazën e së cilës propozon zgjidhje alternative për përparimin e qasjes deri te këto barna për pacientët në Maqedoni. Në këtë drejtim, është e domosdoshme përgatitja e zgjidhjes së re ligjore e cila do të mundësojë qasje ligjore deri te barnat nga kanabisi në forma të ndryshme dhe me përqendrimet përkatëse për trajtimin e numrit shumë më të madh të gjendjeve shëndetësore sesa që janë të lejuara tani, por edhe me çmime të cilat do të jenë në kuadër të mundësive financiare të qytetarëve. Kjo nënkupton heqjen e kushteve të rrepta për kultivimin e kanabisit, vënien e një pjese të barnave në listën pozitive, si edhe krijimin e hapësirës për pacientët, ose për personat të caktuar prej tyre, që të mund t'i përgatitin vetëm preparatet nga kanabisi për përdorim personal.

Projekti "Qytetarët në Kuvend: Iniciativat legjislative për të drejtat e njeriut" është finansuar nga Unioni evropjan

Veprimi shërues i kanabisit ka qenë i njohur që para erës së re. Por, mjekësia bashkëkohore gjatë kohë e linte pas dore fuqinë terapeutike të kësaj bime, me besë për shkak të prirjes (trendit) së ndalimit, nga shkaqet të cilat janë jashtë vatrës së këtij dokumenti, i cili ka filluar kah fundi i 1930-tave. Megjithatë, në disa dekada të kaluara u rritën dëshmitë shkencore për veprimin e preparateve të kanabisit në mjekimin e numrit të madh të gjendjeve shëndetësore, midis të cilave: skleroza multiple, epilepsia, sëmundjet malinje (kanceri), pezmatimet reumatike e nyjave, Sëmundja e Parkinsonit, Sëmundja e Kronit, kaheksia, presioni i rritur (intraokular) i syrit, depresioni, dhembja kronike, si edhe në zbutjen e efekteve anësore të kimioterapisë për kancer, në mjekimin e verdhëzës dhe HIV-it, dhe shumë të tjera. Prandaj, shumë vende e zëvendësuan ndalimin me legalizimin e kanabisit për përdorim mjekësor.

### Në Maqedoni, kanabisi trajtohet padrejtësisht si medikament më i rrezikshëm

Me ndryshimet e Ligjit për kontrollin e drogave dhe substancave psikotropike të cilat Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i miratoi në muajin shkurt të vitit 2016, shteti ynë u bë i 14-ti në Evropë dhe i 3-ti në rajon që e legalizoi përdorimin e kanabisit për qëllime mjekësore. Por, rezultatet e para të zbatimit të Ligjit tregojnë se efektet nuk e plotësojnë qëllimin e kësaj reforme ligjore. Pëkundër asaj që në tekstin hyrës të propozim-ligjit theksohet se “Kanabisi, i ashtuquajtur “marihuana, liri/kërpi” është një nga barnat më të sigurta të arritshme sot” dhe se “Shumë e ulët është incidenca e reaksionit negativ ose alergjik nga kanabisi”, dispozitat e ligjit e trajtojnë kanabisin si bar më i rrezikshëm për kultivimin e të cilit janë të autorizuar vetëm persona juridikë të cilët do të sigurojnë hapësirë atmosferike të mbrojtur me gardh të lartë më së paku 4 metra të rrethuar me 3 rreshte teli me gjemba dhe me sigurim të vazhdueshëm video dhe fizik, si edhe personel tjetër të obligueshëm. Këto kritere të rrepta të sigurimit i favorizojnë personat juridikë me fuqi të madhe financiare për kultivimin e kanabisit, duke pamundësuar në atë mënyrë konkurrencën e tregut. Ata njëkohësisht imponojnë shpenzime të panevojshme, që në mënyrë të pashmangshme kontribuon për çmime të larta të barnave.

### Monopoli mbi kultivimin e kanabisit dhe prodhimi i vajit rezulton me barna jocilësore dhe të shtrenjta.

Vaji i kanabisit vetëm me CBD u gjend në shitje në qershor të vitit 2016 me çmim prej rreth 3000 denarësh, kurse nga shtatori në barnatoret është në dispozicion edhe vaji me përqendrime minimale të THC-së dhe CBD-së i cili jepet vetëm me recetë mjekësore dhe kushton prej 5000 deri në 9000 denarë. Këto çmime janë larg mundësive financiare të qytetarëve, kurse përqendrimet e THC-së dhe CBD-së nuk i pasqyrojnë nevojat e mjekimit as për listën e shkurtër të gjendjeve mjekësore për të cilat është lejuar shkrimi i recetave për preparatet nga kanabisi. Prandaj, pacientët janë të detyruar të furnizohen me kanabis ose vaj në mënyrë të paligjshme, nga tregu i zi në Maqedoni ose nga vendet fqinje, duke e ekspozuar vetveten dhe familjet në rrezik dhe duke ardhur në konflikt me ligjet. Një nënë me fëmijë me epilepsi thekson se vaji i përshtatshëm për mjekimin e kësaj gjendjeje shëndetësore ende nuk është i arritshëm në shitje. Përkundër rreziqeve ajo vetë vjel kanabis të egër dhe përgatit vaj për fëmijën e saj, ndërsa sasi të vajt të nevojshëm për 6 muaj e kushton vetëm 1000 denarë. Prandaj ajo ishte skeptike se edhe në qoftë se vaji përkatës do të mund të gjendej nëpër barnatoret, çmimi nuk do të ishte e pranueshëm për familjen e tyre. Mjekët-profesionistë nuk janë të habitur që tregu i zi mbijeton sepse, sipas tyre, pacientët do të vazhdojnë të furnizohen me vaj atje ku është më i lirë. Ata pajtohen se format e vajt të cilat janë në dispozicion në shitje nuk janë me përqendrime adekuate për mjekimin e sëmundjeve të ndryshme, ndërsa një onkolog ilustron se nuk mund të pritet që pacientët të pinë 100 mililitra vaj që ta marrin dozën e nevojshme të përbërësve aktive të THC-së dhe CBD-së. Është e pakontestueshme se zgjidhja ligjore aktuale e promovon monopolin mbi kultivimin e kanabisit dhe prodhimin e barnave, duke pritur njëkohësisht se pacientët të cilët vuajnë nga sëmundjet e rënda kronike do t'i marrin përsipër të gjitha shpenzimet financiare.



## Lista e indikacioneve mjekësore për përdorimin e kanabisit duhet të zgjerohet

Ligji lejon shkrimin e recetave për barnat nga kanabisi vetëm me rekomandim të specialistëve të onkologjisë dhe radioterapisë, nevrologjisë ose të sëmundjeve infektive të cilët janë të punësuar në institucion shëndetësor publik i cili kryen veprimtari shëndetësor spitalor, dhe vetëm mbi bazën e deklaratës së nënshkruar për pëlqim nga ana e pacientëve. Kërkesa e pëlqimit është e panvojshme për barin me efekte të padëshirueshme të papërfillshme, siç është kanabisi, dhe thjesht kontribuon në rritjen e stigmës ndaj barnave nga kanabisi dhe shkrimit të tyre të kohë pas kohëshme nga ana e mjekëve. Mundësia e shkrimit të recetave vetëm pas rekomandimit të specialistëve të punësuar në institucionet shëndetësore-publike, përsëri, e cenon të drejtën e pacientëve për zgjedhjen e lirë të mjekut.

Shkrimi i recetave për barna nga kanabisi lejohet vetëm për pacientët me sëmundje malinje, me sklerozë multiple, me sindroma të rënda epileptike në moshën fëmijërore dhe për njerëzit të cilët jetojnë me HIV. Por kanabisi mund të ketë efekte terapeutike në më shumë gjendje shëndetësore. Këtë e vërtetojnë studimet e shumta shkencore mbi bazën e të cilave vendet e tjera të botës i krijojnë politikat kombëtare. Për shembull, në Izrael, lista e gjendjeve shëndetësore për të cilat është indikuar përdorimi i kanabisit përmban dhjetëra sëmundje, kurse Ministria e Shëndetësisë e Izraelit vazdhimisht e zgjeron mbi bazën e rekomandimeve nga ana e mjekëve dhe dëshmimeve shkencore. Shpenzimet e mjekimit me preparatet nga kanabisi në tërësi i merr përsipër shteti. Në Kanada, megjithatë, nuk ekziston kufizimi i indikacioneve mjekësore, dhe çdo mjek mund të shkruajë receta për barna nga kanabisi mbi bazën e vlerësimit të tij profesional. Sigurimi shëndetësor i mbulon shpenzimet për kanadezët me sëmundje të rënda dhe kronike për mjekimin me

kanabis, kurse në rastet e tjera pacientët vetëm furnizohen me barna. Në të dyja vendet, në treg janë të arritshme forma të llojllojshme të kanabisit me qëllim të mjekimit të gjendjeve të ndryshme shëndetësore, dhe përveç vajit, pacientët mund të blejnë preparate nga kanabisi të cilat mund t'i konsumojnë si avull, duhan, ushqim, për përdorim të jashtëm etj. Edhe në Kanada edhe në Izrael, pacientët të cilët kanë rekomandim mjekësor mund të marrin edhe leje për kultivimin e sasisë së caktuar të kanabisit që t'i përgatisin vetëm barnat e tyre. Këto praktika të mira lehtë mund të përshtaten edhe në Maqedoni, në ç'rast qytetarëve të cilët kanë nevojë për mjekim do t'u mundësohet qasje e papenguar deri te preparatet në formë përkatëse, përqendrim të nevojshëm dhe me shpenzim të pranueshëm ose pa kurrfarë shpenzimesh financiare.

## Kriminalizimi i zotërimit të kanabisit për përdorim personal është në kundërshtim me prirjet (trendet) dhe rekomandimet ndërkombëtare

Me ndryshimet e Ligjit për kontrollin e drogave dhe substancave psikotropike nga muaji shkurt i vitit 2016, për herë të parë në Maqedoni, ishin miratuar edhe dispozitat ndëshkimore të cilat e kriminalizojnë zotërimin e kanabisit për përdorim personal. Ato janë drejtpërdrejt në kundërshtim me dispozitat tanimë ekzistuese në Kodin Penal të cilat nuk parashikojnë masa të ngjashme. Përveç që shkakton pasiguri juridike në kundërshtim me Kushtetutën e RM-së, hyrja e këtillë është në kundërshtim edhe me trendet ndërkombëtare për liberalizimin e politikave për drogat dhe rekomandimet e agjencive kompetente të OKB-së. Prandaj, Maqedonia duhet ta pranojë rekomandimin e Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të OKB-së e dhënë në qershor të vitit 2016 dhe ta rishikojë këtë dispozitë në mënyrë që do ta anulojë dispozitën kufizuese të Ligjit.



Zgjidhja ligjore ekzistuese për përdorimin mjekësor të kanabisit në Maqedoni nuk i shërben qëllimit për të cilin është sjellë. Është i domosdoshëm ndryshimi i legjislacionit i cili do t'i marrë parasysh nevojat e pacientëve dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera. Prandaj rekomandohet:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia për Barnat dhe Mjetet Mjekësore, përmes një debate publike përkatëse dhe konsultimit të opinionit profesionist dhe të pacientëve, duke i pasur parasysh përvojat e mira nga bota, të përgatitin propozim-ligj të ri me të cilin do të rregullohet përdorimi mjekësor i kanabisit në Maqedoni. Ligji i ri duhet t'i japë vetëm drejtimit dhe dispozitat e përgjithshme, kurse, megjithatë, prodhimi, përpunimi, shpërndarja dhe shkrimi i recetave për preparatet nga kanabisi duhet të rregullohet në nivel më të ulët, me rregullore të përgatitura nga institucionet kompetente.
- Në përgatitjen e zgjidhjes së re të propozim-ligjit, Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia për Barnat dhe Mjetet Mjekësore duhet t'i lënë jashtë kushtet e rrepta të imponuara të tanishme për kultivimin e kanabisit mjekësor dhe duhet të mundësojnë kornizë ligjore në të cilën pacientët me rekomandim mjekësor, ose persona të caktuar prej tyre, do të mund vetëm të kultivojnë kanabis dhe ta përgatitin barin e tyre.
- Ministria e Shëndetësisë duhet të nxisë nismën për krijimin e listës përkatëse të sëmundjeve dhe degëve të specializuara që janë kompetente për shkrimin e recetave për preparatet nga kanabisi, mbi bazën e provave dhe përvojave shkencore nga Maqedonia dhe nga bota. Duhet krijuar protokolle funksionale për rimbushjen e kësaj liste, sikurse edhe rregulla të qarta për shkrimin e rekomandimeve/recetave mjekësore.
- Agjencia për Barnat dhe Mjetet Mjekësore në regjistrin e barnave duhet ta shtojë vajin e kanabisit me përqendime të ndryshme të substancave aktive, në pajtim me nevojat për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme. Në këtë listë duhet shtuar edhe preparate të tjera nga kanabisi që janë të dobishme për mjekim (për konsumim si avull, duhan, ushqim, për përdorim të jashtëm etj.).
- Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia për Barnat, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Odën Mjekësore duhet të sigurojnë mundësi për edukimin shtesë të punëtorëve shëndetësorë nga degët mjekësore kompetente për shkrimin e recetave për barnat nga kanabisi.
- Fondi i Sigurimit Shëndetësor në listën pozitive të barnave duhet t'i shtojë preparatet nga kanabisi.
- Kuvendi i RM-së duhet t'i heqë urgjentisht dispozitat e Ligjit për kontrollin e drogave dhe substancave psikotropike me të cilat kriminalizohet zotërimi i kanabisit ose i preparateve të tij për përdorim personal.

**Nëntor 2016**

**Autorët:**

Natasha Boshkova dhe Ivica Cekovski

Tërë dokumenti për politikën publike mbi bazën e të cilit është përgatitur kjo përmbledhje mund ta gjeni në faqen e internetit të HOPS-it, në pjesën e botimeve ([www.hops.org.mk](http://www.hops.org.mk))

**Autorë:**



**Implementuesit e projektit:**

